



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2615 Prot.

Tiranë, më 02/10 /2025

V E N D I M

Nr. 53, datë 02.10.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E KALIMIT TË FUSHËS SË KËRKIMIT “GJEODINAMIKË” NGA
DEPARTAMENTI I SIZMOLOGJISË NË DEPARTAMENTIN E GJEEOLOGJISË, NË
INSTITUTIN E GJEOSHKENCAVE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa ç, Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 9, pika 3, germa c, shkresës së Institutit të Gjeoshkencave, Nr. 165/5 Prot., datë 25.03.2025 dhe dakordësisë së shprehur nga Departamenti i Sizmologjisë dhe Departamenti i Gjeologjisë, në shkresën e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike me Nr. 858/1 Prot., datë 29.09.2025, “Relacion për miratimin e kalimit të fushës së kërkimit ‘Gjeodinamikë’ nga Departamenti i Sizmologjisë në Departamentin e Gjeologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.10.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalimin e fushës së kërkimit “Gjeodinamikë” nga Departamenti i Sizmologjisë në Departamentin e Gjeologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Ndryshimi strukturor përfshin gjithashtu kalimin e pozicioneve të punës si më poshtë:
 - 1 (një) pozicion pune personel akademik, kalon nga Departamenti i Sizmologjisë në Departamentin e Gjeologjisë;
 - 2 (dy) pozicione pune personel ndihmës akademik, kalojnë nga Departamenti i Sizmologjisë në Departamentin e Gjeologjisë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Instituti i Gjeoshkencave për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

